

## Çmenduria teknike e “Zogut të Zi”

[Shqip, 10.04.2006]

Po qe se i lihet në dorë kryeministrit aktual, ai do ta prishë nënkalimin e Zogut të Zi, vetëm për motive të luftës politike me opozitën. Kemi shkruar vetëm për anën juridike, politike dhe morale të problemit. Por tani, duke dëgjuar çmenduritë teknike të hedhura në masmedia nga ca ekspertë kryeministorë, thamë të thyejmë tabunë “flasin vetëm ekspertët”—nëse do të kishim lënë gjithnjë të flisnin vetëm ekspertët, sot akoma do të ishim në komunizëm!

Po përpigën të ju bëjnë të besoni se **rrethrotullimi e kryen njësoj punën si nënkalimi**—bile dhe më mirë!. Edhe në budallallëqe nuk janë origjinalë: kur dolën veturat e para, para nja 100 vjetësh, ka patur “ekspertë”, që parashikonin dështimin e veturës para karrocës. Sot po ju thonë edhe se “nënkalimet i përdor pakkush në botë”, pavarësisht se shumica juaj ka kaluar në autostradat e botës, duke u përshkuar nëpër qindra nënkalimet, ku mbi kokat tuaja kalonin jo vetëm makina, por edhe pistat e aeroplanëve. Ju i dini mirë këto, por kujdes se propaganda e kryeministrit ka efekte të forta lavazhi të trurit.

Në rrugën Tiranë-Durrës, e **shohim konkretish ndryshimin e një nënkalimi me një rrethrotullim**. Në dalje të Durrësit ka pranë e pranë një nënkalim (ai poshtë mbikalimit për në Plazh) dhe një rrethrotullim ngjitur. Ndryshimi është si nata me ditën: rrethrotullimi shpesh i bllokuar, kurse nënkalimi fare i lirë sado makina të ketë.

Mos harroni se e kemi patur rrethrotullimin tek Zogu i Zi, e mos harroni se ç’tmerr ishte ta kaloje—prandaj dhe u nis nënkalimi! Nëse do të kthehemi prapë mbrapsht tek **rrethrotullimi, sipas kryeministrit**, makinat që hyjnë drejt për në qendër të Tiranës, prapë do të detyroheshin të ulnin shpejtësinë, të gjitha, jo vetëm nga rreziku i përplasjes me makinat që ecin në drejtimin tërthor, por edhe sikur në rrethrotullim të mos kishte asnjë makinë. Kjo sepse duhet të shkonin detyrimisht sipas harkut—katrahurë e vërtetë, po t’i shtonit tabllor edhe moszbatimin tipik të radhës nga ne shqipot! Kaq rikujtim do të mjaftonte për të neutralizuar lavazhin e trurit që po ju bëjnë përditë.

Mendoni **sikur nënkalimi i Zogut të Zi, të jetë përfunduar**, sipas Bashkisë. Të gjitha makinat për në qendër të Tiranës, do të mund të përshkonin Zogun e Zi me çfarëdo lloj shpejtësie, pavarësisht se sa është fluksi i makinave: rruget do të ishte e drejtë, pa ndërprerje nga makinat e drejtimit tërthor. (Ah sikur të kishim para, dhe ta hiqnim edhe atë rrethrotullimin tek AMC, e ta bënim edhe atë “nën- apo mbikalim”, që t’i shërbente edhe Laprakës!)

“Ekspertët” do të këmbëngulin: “Dakord, por në rastin e Zogut të Zi, **nuk ia vlen nënkalimi, se kushton shumë më tepër se rrethrotullim**”. Edhe ky është një mashtrim.

**Tani, kosto e ndërtimit të nënkalimit të Zogut të Zi është më e ulët se e ndërtimit të rrethkalimit**. Nuk futen më në llogari paratë e shpenzuara deri tani, sepse janë të vdekura (dead costs, thonë amerikanët), sepse janë shpenzuar tashmë—keq a mirë. Duhet llogaritur paratë që do të shpenzohen nga sot e mbrapa. Për nënkalimin—sipas Bashkisë—duhet shpenzuar veç nja 0,8 milionë dollarë. Kurse për një rrethrotullim—sipas Kryeministrit—duhet shpenzuar shumë më tepër se 0,8 milionë dollarë, sepse së pari duhet prishur nënkalimi dhe pastaj të ndërtohet rrethrotullimi.

Ekspertët kryeministorë do të vazhdonin me “distancat urbanistike”, “rreziqet e nënkalimit”, “pamjen e Tiranës” e të tjera sofizma skizofrenike pafund. Nuk duam t’ju lodhim më me to, sepse nuk ia vlenë. Vetëm po ju kujtojmë, se ai që i urdhëron, kryeministri aktual, nuk

po lë njeri të merret fare me “distancat urbanistike” të pallateve “karshi zyrës së tij”, tek Blloku, tek pallatet tek Brryli në Durrës, tek Plazhet e Durrësit, tek qindra pallate në Sarandë e gjetkë në gjithë Shqipërinë, që përbëjnë masakrën e vërtetë urbanistike shqiptare, e që janë qartë e matematikisht në shkelje të ligjit urbanistik—fundja, nënkalimi i Zogut të Zi mbikqyret nga një autoritet i lartë, nga Bashkia e Tiranës, prandaj nuk i takon të merret aq kryeministrit personalisht!

Njerëzit duhet t’i ruajnë vetes të drejtën për të menduar me kokën e vet, edhe kur u thonë se “janë çështje që u takojnë vetëm ekspertëve”.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 2.4.2006